Nr. 10	P08130.O1.A10. Ndertim Fusha Sportive	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Rikualifikimi i 3 fushave sportive ne shkollat e territorit te Bashkise se Shkodres		
i. Situata		
<p>Projekti “Jeto me Sportin” synon rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të komunitetit në sa më shumë aktivitete sportive duke zhvilluar më tej traditat sportdashëse të banorëve e duke përmirësuar kështu cilësinë e jetesës së tyre.</p> <p>Vizioni i Bashkisë Shkodër është transformimi i territorit në një hapësirë policentrike që ofron shërbime me të njëjtin standard për publikun në mënyrë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga banorët dhe vizitorët.</p> <p>Nxënësit, Shoqatat e klubet e ndryshme sportive për të rinj por edhe komuniteti kanë nevojë të jenë të angazhuar në aktivitete sportive në terrere dhe ambiente të përshtatshme. Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore për 11 njësitë administrative (90 shkolla, 58 kopshte, 2 konvikte dhe 1 shkolle speciale), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Duke pasur një numër të madh nxënësish që frekuentojnë shkollat në Shkodër, ne duam të kontribuojmë jo vetëm në aktivitetet e edukimit dhe formimit por edhe për aktivitetet sportive, argëtuese e kreative si qendra komunitare në shërbim te komunitetit.</p> <p>Bashkia Shkodrer ka aplikuar prane Fondit te zhvillimit te Rajoneve ne thirrjen e pare per financimin e projekteve nga grantet “Arsimi”, pjese e fondit per zhvillimin e rajoneve per vitin 2018 me shkresën nr prot 10430 date 27.04.2018. Thirrja ishte me kushtin qe 30% te fondit total do te mbulohej me fondet e bashkise. <i>Me deklaraten nr prot 6427 date 27.04.2018, Bashkia Shkoder ka marre persiper te bashkefinancoje 30% e projektit sipas miratimit te projektit “Ndertimi i fushave sportive (P9F1O2A14)” me VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2018 - 2020 të Bashkisë Shkodër”.</i></p> <p>Projekti konsiston ne rikualifikimin e terreneve sportive në 3 shkolla të mesme të Bashkisë Shkodër, përkatësisht një në qytet dhe dy në njësitë administrative.</p> <p>Rikualifikimi i terreneve sportive në shkollën e Mesme të përgjithshme “Oso Kuka”, qytet, pjesë e Lagjes Nr.2, me një popullsi rreth 35 mijë banorë; Sheshi i ndërtesës së Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Oso Kuka”, me një sipërfaqe rreth 2500 m2, aktualisht shfrytëzohet në mënyrë të improvizuar për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. Sipërfaqja e sheshit është pjesërisht e shtruar (me asfalt) ndërsa pjesa tjetër jo. Terreni ku zhvillohen aktivitetet sportive është në gjendje jo të mirë, duke penguar kështu ushtrimin normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht mund të konstatohet që sheshi është i papërshtatshëm për çdo aktivitet sportiv dhe rekreativ</p> <p>Në shkollën e Mesme të Bashkuar At “Gjon Karma” Njësia Administrative Guri i Zi me një popullsi prej 11838 banorë; aktualisht nuk mund të shfrytëzohet për aktivitete sportive për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtruar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohen aktivitetet sportive është në gjendje jo të mirë, gjë që pengon në ushtrimin normal të proceseve mësimore dhe aktiviteteve sportive. Sheshi ku zhvillohen programet mësimore të edukimit fizik dhe aktivitetet sportive dhe rekreative është jashtë çdo standardi.</p> <p>Në shkollën e mesme “Gjimnazi Oblike”, Njësia Administrative Ana e Malit me një popullsi prej 5968 banorë. me një sipërfaqe rreth 2225 m2, aktualisht shfrytëzohet në mënyrë të improvizuar për shkak të kushteve në të cilat ndodhet. E gjithë sipërfaqja e sheshit është e pashtruar, një pjesë e madhe e terrenit ku zhvillohet aktivitetet sportive është ne gjendje jo të mirë, gjë që pengon ushtrimin normal të aktiviteteve sportive. Aktualisht sheshi i planifikuar për zhvillimin e programit mësimor të edukimit fizik dhe aktiviteteve sportive dhe rekreative nuk plotëson kushtet për zhvillim të rregullt të këtyre aktiviteteve.</p> <p>Bazuar ne Vendimin e KZHR nr 7 date 11.05.2018 “Detajim i Fondit per zhvillimin e rajoneve” dhe shkresen e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr prot 9795/3 date 06.06.2018 keto fonde per investime si bashkefinancim nga KZHR ne projektin “Jeto me Sportin” Rikualifikim i terreneve sportive ne shkollat “ Oso Kuka” Shkoder, “Ana e Malit Oblike” dhe “At Gjon Karma” Gur i Zi jane akorduar programi 8140 “Zhvillimi i Sportit”, zeri investime, ne instiucionin Bashkia Shkodër.</p> <p>Rimodelimi i të gjithë shesheve, si para ndërtesave, ashtu edhe prapa, i kthen këto sheshe në hapësira multifunkionale. Hapësirat rekreative do të mund të përdoren si nga nxënësit dhe mësuesit ashtu edhe nga i gjithë komuniteti në territorin administrativ ku ndodhen shkollat.</p>		
ii. Synimi i projektit		
Qëllimi i përgjithshëm i projektit ‘Jeto me Sportin’ është përmirësimi i cilësisë së jetesës së banorëve të Bashkisë Shkodër duke i mundësuar çdo fëmije, të riut dhe të reje që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitetet sportive. Objektiv i specifik i këtij projekti është rikualifikimi i ambienteve dhe infrastrukturës sportive në shkollat të Bashkisë Shkodër duke krijuar kushte		

sipas standardeve për zhvillimin e aktiviteteve sportive.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla Oso Kuka; • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla At Gjon Karma; • Rikualifikim i ambienteve sportive shkolla Gjmnazi Oblikë; 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i orëve të fiskulturës në mënyrë të rregullt. • Zhvillimi i disiplinave të ndryshme sportive për nxënësit e shkollave. • Hapja e shkolles si qender komunitare për nxënësit por edhe për të rinjtë që jetojnë aty. 						
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
Bashkia Shkodër Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit Fondi për Zhvillimin e Rajoneve				Bashkia Shkodër Fondi për Zhvillimin e Rajoneve		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Zbatimi i projektit	20443				20443
	Shuma	20443				20443
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër				



Nr.11	P08130.O1.A11. Kampionati i Pavarësisë	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081 Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130 Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit : Kampionat lojresh me dore mes shkollash te mesme te Bashkise se Shkodres							
i. Situata							
<p>Lojrat me dorë në Shkodër kanë një traditë të hershme dhe histori të suksesshme në sportin shqiptar. Ekipet e basketbollit dhe të volejbollit për meshkuj e femra kanë arritur rezultate shumë të mira në të gjithë aktivitetet kombëtare duke përfaqësuar e përçuar vlerat e qytetit në vende të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p>Deri në fillim të viteve 90 janë zhvilluar periodikisht kampionate të lojrave me dorë në mes të shkollave të mesme. Prej disa vitesh këto kampionate nuk zhvillohen, për pasojë është ulur numri i të rinjve që praktikojnë sportet e basketbollit dhe të volejbollit duke sjellë kështu edhe më pak talente për ekipet e Vllaznisë.</p> <p>Për vitin 2019 ashtu si edhe në vitin 2017 dhe 2018, Bashkia Shkodër do të bashkëpunojë me Qendren Kulturore të Fëmijëve, SK Vllaznia dhe DAR për realizimin e këtij projekti, duku ofruar asistencën dhe profesionistët e duhur në ndihmë të aktivitetit.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Të gjallërojmë jetën sociale të të rinjve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive Promovimit të sportit si veprimtari sociale, integruese dhe burim shëndeti. Afrimi i të rinjve me sportin por dhe me njëri tjetrin. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> Ngritja e grupit organizator me përfaqësues e specialistë të sportit nga Bashkia Shkodër, DAR, klubi Vllaznia etj. Përgatitja e grafikut të takimeve ndërmjet ekipeve të lojrave me dorë brenda shkollës dhe më pas ndërmjet shkollave të mesme. Organizimi i ndeshjeve të shkollave mes njëra-tjetrës. Evidentimi i talentëve të reja në funksion të ekipeve të moshave për Sport Klub Vllaznia. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje të rinjve në aktivitete sportive. Ngritja e skuadrave të reja dhe seleksionimi i më të mirëve për ekipet e fëmijëve dhe të rinjve. Shtimin e aktiviteteve sportive në shkolla Argëtimin si sportdashës të nxënësve. 							
c) Aktoret e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt				
DAR Klubi shumësportesh Vllaznia Klubet e Vllaznisë të volejbollit dhe basketbollit			Bashkia Shkodër				
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Tota li (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operativ e	Transferim e	Kapitale
.1	Materiale publicitare, kupa						
.2	Honorare arbitra 4x25 000 lek/person	100			100		
	Shuma	100			100		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Tota li (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	O perative	Tra nsferime	Kapit ale
.1							
	Shuma						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Tota li (mije lekë)	Nga kjo:				
			aga	Sig urime	O perative	Tra nsferime	Kapit ale



.1							
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2019 Janar - Dhjetor 2020 Janar - Dhjetor 2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër					



Nr. 12	P08130.O1.A12. Ditet e Vullnetarizmit	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim					
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit: Organizimi i diteve të vullnetarizmit me të rinjtë.							
i. Situata							
<p>Në territorin e bashkisë së Shkodrës, zhvillohen aktivitete vullnetare. Këto aktivitete organizohen nga grupe jo shumë mirë të koordinuara dhe aktivitetet që organizohen, janë të dobishme por nuk janë në përputhje me nevojat emergjente që paraqet qyteti. Gjithashtu, vullnetarizmi është një mundësi zhvillimi personal dhe profesional i të rinjve, dhe nuk shfrytëzohet pothuajse fare nga të rinjtë e qytetit të Shkodrës.</p> <p>Të gjendur para kësaj situatë dhe duke besuar në vlerat e vullnetarizmit, mendojmë të vazhdojmë të organizojmë aktivitete të ndryshme vullnetarizmi të shtrira përgjatë gjithë vitit. Këto aktivitete kanë për qëllim promovimin e vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimin e të rinjve përpërfshirje në të tilla aktivitete.</p>							
ii. Synimi i projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Synojmë edukimin e të rinjve në fushata ndërgjegjësuëse për përfshirje në aktivitete vullnetare. • Synojmë promovimin e vullnetarizmit si mundësi për të fituar aftësi të reja, si mundësi për zhvillimin në karrierë, si mundësi për njohje vlerash etj. • Synojmë nxitjen e vullnetarizmit, për përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale, kulturore, etj, në qytetin e Shkodrës. 							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i aktiviteteve të ndryshme vullnetare përgjatë gjithë vitit. • Bashkëpunim me institucionet publike, kryesisht DAR, universiteti, organizatat, etj. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjësimi i të rinjve dhe mbarë komunitetit për përfshirje në aktivitete vullnetare. • Përfshirje e të rinjve në aktivitetet vullnetare që do organizohen përgjatë gjithë vitit. • <input type="checkbox"/> Bashkëpunim me institucionet publike dhe organizatat për aktivitetet e ndryshme që do organizohen gjatë vitit. • <input type="checkbox"/> Përmirësimi i situatës mjedisore, sociale, kulturore, etj, si pasojë e zhvillimit të aktiviteteve vullnetare gjatë vitit. 							
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt			
Të rinjtë DAR Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" Komuniteti				Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për vitin 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime për aktivitetet.		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma						
Shpenzimet për vitin 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime për aktivitetet.		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma						
Shpenzimet për vitin 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
A.1	Shpenzime për aktivitetet		Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
	Shuma						
f) Periudha e zbatimit Janar - Dhjetor 2019 Janar - Dhjetor 2020 Janar - Dhjetor 2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër					



Nr.13	P08130.O2.A1. Menaxhimi i Sport Klub Vllaznia	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim						
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mirembajtja dhe administrimi i Sport Klub Vllaznia								
i. Situata								
Sport Klub "Vllaznia" është themeluar në vitin 1919 me emrin KS Bashkimi ndërsa në 1929 u quajt Bashkimi Shkodran dhe në 1939 merr pjesë për herë të parë në Kampionatin Shqiptar të Futbollit të Kategorisë së parë. Në vazhdimësi Sport Klub Vllaznia, siç quhet sot, është dalluar në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare për rezultatet e larta në shumë disiplina sportive. Aktualisht Klubi menaxhon dhe zhvillon 15 disiplina sportive dhe përbën një ndër klubet më të rëndësishëm dhe më të suksesshëm në Shqipëri. Pikërisht edhe përmirësimi i performancës në administrimin e klubit me qëllim rritjen e performancës përbën edhe sfidën më të madhe për Bashkinë Shkodër në drejtim të zhvillimit të sportit në territorin e Shkodrës. Krijimi i kushteve sa më të mira për ushtrimin e aktiviteteve të disiplinave të ndryshme sportive do të krijonte kushte për rritjen si cilësore në rezultate më të larta ashtu edhe sasiore në rritjen e numrit të sportistëve. Pagat dhe sigurimet paguhen per21 punonjës. Për mbarëvajtjen e stervitjes duhet të blihen dhe materiale sportive si complete sportive, topa, sfungjer për disiplinën e atletikës, uniforma zyrtare për ndeshje. Mjetet kancelarike dhe materialet e pastrimit janë shumë të rëndësishme në mbarëvajtjen e punës gjatë vitit. Karburanti përdoret për shoqërimin e ekipit të ciklizmit. Në shkurt të vitit 2019 Sport Klub Vllaznia ka 100 vjetorin e themelimit, do vlerësohet mundësia për ndërtimin e një muzeu të sportit për qytetin, kontributi mund të jetë edhe nga çdo donator që dëshiron të jetë pjesë.								
ii. Synimi i projektit								
Nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të Sport Klub Vllaznia synohet rritja e performancës së ekipeve sportive Vllaznia.								
iii. Aktivitetet kryesore të projektit								
<ul style="list-style-type: none"> • Pagesë e faturave të energjisë elektrike dhe të ujit për te gjithë ambientet ku sterviten ekipet e lojrave me dore, boksit, peshengritjes dhe ciklizmit. • Pagesë e faturave të internetit për administraten, federatat, trajneret . • Krijimi i kushteve per zhvillimin normal te aktiviteteve sportive • Zhvillimi i stërvitjeve në kushte normale me synim rritjen e cilësisë sportive. • Aktivitete miqësore. • Aktivitete kombëtare. • Aktivitete nderkombetare • Sigurohet zhvillimi normal i stervitjeve dhe pjesmarria ne aktivitetet kombetare e nderkombetare te boksit 								
b) Rezultatet që prisni								
<ul style="list-style-type: none"> • Rezultate të larta të sportistëve të Sport Klub Vllaznisë • Shpallje të ekipeve kampione kombëtarë 								
c) Aktoret e mundshëm					d) Kontributet e mundshme në projekt			
Bashkia Shkoder					Bashkia Shkodër			
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019			Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
				Paga	Sigurime	Operative	Transf erime	Kapit ale
A.1	Paga per punonjes	10201	10201					
A.2	Sigurime Shoqerore	1623		1623				
A.3	Energji elektrike	775				775		
A.4	Uje	110				110		
A.5	Sherbime internet	50				50		
A.6	Sherbime postare	5				5		
A.7	Mirëmbajtje material zyre	50				50		
A.8	Blerje materiale sportive	850				850		
A.9	Blerje kancelari per zyrat	80				80		
A.10	Blerje materiale pastrimi	70				70		
A.11	Blerje karburant	250				250		
A.12	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	300				300		
A.13	Blerje boje per lyerje	100				100		
A.14	Blerje rrjetë najloni për rrethimin e fushës së stërvitjes të Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi"	100				100		
A.15	Blerje skelë metalike për mirëmbajtjen e ndricimin e sallës së stërvitjes të Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi" 10m	100				100		



A.16	Blerje bileta	50			50		
	Shuma	14777	10201	1623	2953		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime	Kapit ale
A · 1							
	Shuma	16382	10330	1726	2826		1500
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transf erime	Kapit ale
A · 1							
	Shuma	16507	10330	1726	2951		1500
f) Periudha e zbatimit Janar 2019- Dhjetor 2019 Janar 2020- Dhjetor 2020 Janar 2021- Dhjetor 2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtorja e Kulturës, Arsimit Rinisë dhe Sportit Sport Klub Vllaznia Institucioni likuidues :Sport Klubi Vllaznia					



Nr. 14	P08130.O2.A2. Administrimi dhe Mirembajtje e Stadiumit "Loro Borici"	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mirembajtja e stadiumit 'Loro Borici'		
i. Situata		
<p>Stadiumi "Loro Borici" është pasuri e paluajtshme, pronë publike, në pronësi të Bashkisë Shkodër. Kjo pronë ka kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër me VKM nr. 421, date 2.6.2010 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër", me nr. 221 rendor në listë të inventarit.</p> <p>Këshilli Kombëtar i Territorit të Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 1, datë 1.4.2015 ka miratuar kërkesën e Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) për të investuar në rikonstruksionin e këtij objekti. Përfitues i këtij investimi është Bashkia Shkodër.</p> <p>FSHF dhe Bashkia Shkodër kanë nënshkruar një Marrëveshje (Nëntor 2015) me qëllim bashkëpunimin për rikonstruksionin, përdorimin dhe manaxhimin e këtij impianti sportiv në pronësi të Bashkisë Shkodër pas realizimit të konstruksionit të Stadiumit "Loro Borici".</p> <p>Bashkia Shkodër ka filluar procedurën për marrjen në dorëzim të punimeve të objektit të Stadiumit "Loro Borici". Kështu me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 477 datë 26.06.2018 është ngritur grupi i punës "Për marrjen në dorëzim të objektit stadiumi "Loro Borici" dhe të dokumentacionit tekniko-ekonomik sipas investimit të realizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit".</p> <p>Grupi i punës, verifikoi dokumentacionin tekniko-ligjor, i cili përbëhej nga 24 dosje tekniko-ligjore me një total dokumentacioni prej 3851 dokumentash, bazuar në: Ligjin nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, ligjin nr 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, VKM nr 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" të ndryshuar, VKB nr 50 datë 04.12.2015 "Për miratimin e marrëshjes ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Federata Shqiptare e Futbollit "Për rikonstruksionin dhe përdorimin e Stadiumit "Loro Borici", dhe vëren se :</p> <p>1.Ne zbatim të VKM nr 408/2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit " të ndryshuar neni 25 ,27 dhe 27/1 në dokumentacionin e shqyrtuar mungonin:</p> <p>1.1 Dokumenti i Lejes së Ndërtimit në zbatim të Vendimit të KKT nr1 datë 01.04.2015 si edhe pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë kjo bazuar në pikën 4 të këtij Vendimi.</p> <p>1.2 Aktet e kontrollit nga Subjekti mbikqyrës si më poshtë:</p> <p>a. Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik; etj .</p> <p>b. Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese."</p> <p>Të gjitha Aktet e Kontrollit duhet të jenë të shoqëruara me një <u>deklaratë përgjegjësie</u>, të plotësuar nga <u>subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar</u>, sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes.</p> <p>2. Referuar Udhëzimit nr 3 dt 15.02.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, në dokumentacionin e verifikuar mungonte:</p> <p>2.1 <u>Relacioni përmbledhës i Mbikqyrës të Punimeve</u> për të gjithë periudhën prej fillimit deri në përfundim të objektit shoqëruar tabelën e likujdimit sipas situacioneve.</p> <p>2.2 <u>Situacioni përfundimtar i punimeve.</u></p> <p>2.3 <u>Akti i Kolaudimit përfundimtar të objektit</u></p> <p>2.4 Vërtetimi i institucioneve përkatëse për Lidhjen me Energji Elektrike, Ujësjellës-kanalizime si edhe Certifikatën nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.</p> <p>2.5 Oponenca teknike e objektit, bazuar në VKM nr 363/2002 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve"(për vlerë mbi 100.000.000 lek)</p> <p>2.6 Certifikata e përdorimit të objektit,</p> <p>3.Bazuar në VKB nr 50 datë 04.12.2015 "Për miratimin e marrëshjes ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Federata Shqiptare e Futbollit "Për rikonstruksionin dhe përdorimin e stadiumit "Loro Borici" neni 4 i marreveshjes percakton se <i>Federata i</i></p>		

dorezon Bashkise me procesverbal, objektin e perfunduar sipas procedurave te ligjit "Per planifikimin e territorit", te ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", te VKM nr. 732 date 02.09.2015 "Per bashkefinansimin e stadiumit "Loro Borici", Shkoder, dhe te specifikimeve teknike-punime ndertimi, te projektit te ndertimit te tribunes kryesore ne Perendim dhe te tribunes ne Jug, Rikonstruksionit te Tribunes Ekzistuese ne Veri dhe ne Lindje, te infrastruktures rrotull stadiumit sipas Normatives se UEFA-2015 ne stadiumin Loro Borici Shkoder, Projekt Zbatimi dhe Preventivi perfundimtar

3.1 Pjesë e marrjes në dorëzim duhet të jetë zbatimi i normativave për infrastrukturën e stadioneve nga UEFA, për këtë duhet një vërtetim/shkresë/konfirmim që Stadiumi plotëson këto kritere.

Bashkia Shkodër me shkresën nr 12731 prot datë 03.08.2018 i është drejtuar FSHF për plotësimin e dokumentacionit në mënyrë që të vijojmë me procedurën e mëtejshme të marrjes në dorëzim të punimeve të objektit.

Sapo Bashkia Shkoder te marre ne dorezim objektin e mesiperem do te vijoje me mirembajtjen e tij sipas shpenzimeve te planifikuara me poshte.

ii. Synimi i projektit

Garantimi i kushtevënë stadiumin "Loro Borici" Shkodër në përputhje me standardet e FIFA, UEFA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, me synim ngritjen e cilësisë sportive të futbollit të qytetit të Shkodrës dhe për të patur mundësi organizimi të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të futbollit dhe të atletikës në këtë objekt sportiv.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Aktiviteti kryesor është mirëmbajtja e ambjentëve sportive të Stadiumit "Loro Borici".
- Një tjetër aktivitet i rëndësishëm është menaxhimi i hapësirave tregtare në ambjentet e Stadiumit.

b) Rezultatet që prisni

- Stadiumi "Loro Borici" duhet të jetë në kushte optimale për zhvillimin e aktiviteteve ndërkombëtare dhe kombëtare të futbollit dhe të atletikës.
- Ambjentet tregtare janë të menaxhuara në mënyrë eficiente për të siguruar të ardhura shtesë në aktivitetin e mirëmbajtjes së Stadiumit.

c) Aktoret e mundshëm

K.F. Vllaznia, S.K. Vllaznia.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Shkodër

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet 2019	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Shpenzime te tjera	3806		3806		
A.2	Ruajtje e godines	2000		2000		
A.3	Shpenzime energji elektrike	1350		1350		
A.4	Shpenzime uje	1200		1200		
A.5	Shpenzime karburanti	444		444		
	Shuma	8 800		8800		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	8 800		8 800		
	Shuma	8 800		8 800		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021	Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Operativ e	Transferi me	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	8800		8800		
	Shuma	8 800		8800		

f) Periudha e zbatimit
Janar - Dhjetor 2019
Janar - Dhjetor 2020
Janar - Dhjetor 2021

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:
Drejtorja e Kultures, Arsimit, Rinise dhe Sportit
Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër



Nr.15	P08130.02.A3. Administrimi i Klubit te futbollit "Vllaznia"	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit: Mbeshtetje per Klubin e Futbollit 'Vllaznia'						
i. Situata						
<p>S.K. Vllaznia, i themeluar në vitin 1919, është shoqëria e parë sportive në Shqipëri. Vllaznia është pa dyshim një nga emrat më të mëdhenj në fushën e sportit kombëtar në përgjithësi, si dhe të futbollit në veçanti. Me 9 tituj kampion (1945, 1946, 1972, 1974, 1978, 1983, 1992, 1998, 2001) dhe 6 Kupa Repubike (1965, 1972, 1979, 1981, 1987, 2008), "Vllaznia" është simbol i Shkodrës dhe krenaria e tifozërisë së saj të shumtë e të zjarrtë.</p> <p>Që nga viti 2011, K.F. "Vllaznia" është shndërruar në shoqëri tregtare, aksionet e së cilës zotërohen 100% nga Bashkia Shkodër.</p> <p>Në sezonin sportiv 2017-2018 ekipi i parë i K.F "Vllaznia" sha ra nga Superliga. Me synimin e ringritjes brenda sezonit sportiv 2018-2019 në Superligë Bashkia Shkodër do te vijojte me mbeshtetjen e K.F "Vllaznia" sha. Nderkohe vazhdon puna për procesin e privatizimit, një proces të filluar që nënëntor të vitit 2017.</p>						
ii. Synimi i projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Për sezonin sportiv 2018-2019, ringritja në Superligë e ekipit të parë të K.F "Vllaznia" • Për sezonin 2018-2019,ndërtimi i nje ekipi konkurruespër vendin e parë të kategorisë së parë. • Për sezonet 2019-2020, 2020-2021 fuqizimi i një ekip cilësor per te qendruar ne superlige. • Per sezonin 2019-2020, ndertimi i nje ekipi konkurrues ne Kupat e Europes. • Vazhdimi i mbështetjes të ekipeve zinxhir te akademise Vllaznia. • Përfundimi i procesit të privatizimit të K.F. Vllaznia sha. 						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i financimit të pagave/shpërblimeve për lojtarët dhe stafin teknik; • Sigurimi i pjesëmarrjes në aktivitetet sportive sipas kalendarit të përcaktuar nga FSHF; • Sigurimi i kushteve optimale të stërvitjes, nëpërmjet mirëmbajtjes së ambienteve sportive, garantimit të bazës materiale, trajtimit ushqimor të sportistëve, fazave përgatitore, grumbullimeve etj. • Sigurimi i shlyerjes të borxheve të trashëguara. • Vazhdimi i udhëheqjes si dhe respektimi i afateve të procedurës të privatizimit tëK.F. Vllaznia 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Ekip konkurentpër vendin e parë të kategorisë së parë dhe ringritje në Superligë. • Permes realizimit te objektivave te parashikuara synohet nxitja e te rinjve per t'u marre me sport, si dhe rritja e shikshmërisë së sportit në ambientet tona sportive, mbështetja nga tifozeria e qytetit. • Përmirësimi i klimës administrativo-financiare. • Mbyllja e procesit të privatizimit K.F. Vllaznia. 						
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
K.F. "Vllaznia", shoqata sportive , sponsor , publiku.				Bashkia Shkodër, sponsor të ndryshëm.		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetje për Klubin e futbollit "Vllaznia"	45 000				45 000
	Shuma	45 000				45 000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetje për Klubin e futbollit "Vllaznia"	45 000				45 000
	Shuma	45 000				45 000
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurim e	Operativ e	Transferi me
A.1	Mbeshtetje për Klubin e futbollit "Vllaznia"	45 000				45 000
	Shuma	45 000				45 000



f) Periudha e zbatimit

Janar 2019- Dhjetor 2019
Janar 2020- Dhjetor 2020
Janar 2021- Dhjetor 2021

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Drejtoria e Kultures, Arsimit, Rinise dhe Sportit

Institucioni likuidues : Bashkia Shkodër



Nr.16	P08130.O3.A1. Ekipi i basketbollit i te rriturve per meshkuj	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim				
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
Ekipi i basketbollit i të rriturve per meshkuj SK "Vllaznia" është pjesë e Shoqates Vllaznia që në vitin 1926 dhe merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHB. Ekipi i Basketbollit i të rriturve i Vllaznise përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Ky ekip ka dalë kampion 9 herë në vitet 1967, 1969, 1990, 1993, 1994, 1995, 2000, 2014, 2015, 2016 Fitues i kupës së Republikës 8 herë në vitin 1957, 1959, 1965, 1989, 2002008, 2013, 2014. Ekipi i Basketbollit synon vendin e katërt për sezonin 2018 – 2019 Baza ligjore per trajtimet ushqimore/trajnerë/gjyqtare apo pagesa per federime Urdher nr.217, date 04.07.2018 " per vlerësimin vjetor të trajtimit ushqimor per sportistet e Sport Klub " Vllaznia", ku jane percaktuar nivelet e vleresimit sipas kategorive te sportisteve (nivele shume i mire, nivele i mire, nivele mesatar, nivele pranueshem me kuotat ditore leke/dite. Ligjit nr.79/2017 "Për sportin", VKM nr.354, DATE 29.8.1994 "per shperblimin e cilesise te veprimtarive sportive,per sportistet, trajneret e gjyqtaret dhe shperblime te tjera sportive", i ndryshuar VKM nr 1720, date 29.10.2008 "për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.						
ii. Synimi i projektit						
Synojme që ekipi i Basketbollit të zhvillojë aktivitetet zyrtare dhe miqësore gjatë v sezonit sportiv 2018-2019, në kushte optimale duke zbatuar rregulloret e FSHB dhe federatës europiane të basketbollit; gjithashtu pjesmarrje në aktivitetet ndërkombëtare duke qënë se niveli i ekipit ndër vite është i lartë.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimit të kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit ose palestra shkollore në bashkepunim me DAR. • Sigurimi i bazës materiale si: topa, uniforma sportive, kosha, tabela, etj. • Trajtim ushqimor të sportistave. • Pagesa me honorare të trajnerëve. • Pagesa e gjyqtarëve. • Sigurimi i regjistrimit të ekipit në Kampionatin Kombëtar. 						
b) Rezultatet që prisi						
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurim i mbarëvajtjes së ekipit të basketbollit për të rritur me qëllim arrijten e objektivave të synuara. • Pozicionimi në vendin e tretë për sezonin 2018-2019. 						
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
SK "Vllaznia", shoqata sportive, sport dashesit, Bashkia Shkoder				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Trajtime ushqimore	1966		1966		
A.2	Pagesa honorare (trajner)	264		264		
A.3	Pagesa gjyqtarësh.	170		170		
A4	Federimi	200		200		
	Shuma	2600		2600		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime operative					
	Shuma	2600		2600		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime operative	2600		2600		
	Shuma	2600		2600		



<p>f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurrpëfundon) Janar 2019- Dhjetor 2019 Janar 2020- Dhjetor 2020 Janar 2021- Dhjetor 2021</p>	<p>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: SK Vllaznia Bashkia Shkodër Institucioni likuidues : Sport Klubi Vllaznia</p>
---	--



Nr.17	P08130.O3.A2. Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj te rinj	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim				
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:						
i. Situata						
<p>Ekipi i basketbollit i te rinjve, SK "Vllaznia", si pjese e Shoqatës Vllaznia, qe ne vitin 1955 merr pjese ne te gjitha veprimtarite kombetare ne baze te rregulloreve te FSHB.</p> <p>Ekipi i basketbollit te te rinjve i Vllaznise perbehet nga 15 sportiste dhe 1 trajner.</p> <p>Ky ekip ka dale kampion kombetar 7 here ne vitet 2005, 2006, 2008, 2011, 2013,2014,2017. Per vitin 2019 synon te dale kampion kombetar.</p> <p>Baza ligjore per trajtimet ushqimore/trajnere apo pagesa per federime</p> <p>Urdher nr.217, date 04.07.2018 " per vleresimin vjetor të trajtimit ushqimor per sportistet e Sport Klub " Vllaznia", ku jane percaktuar nivelet e vleresimit sipas kategorive te sportistevë (nivele shume i mire, niveli i mire, niveli mesatar, niveli pranueshem me kuotat ditore leke/dite.</p> <p>Ligjit nr.79/2017 "për sportin",</p> <p>VKM nr.354, DATE 29.8.1994 "per shperblimin e cilesise te veprimtarive sportive,per sportistet, trajneret e gjyqtaret dhe shperblime te tjera sportive", i ndryshuar</p> <p>VKM nr 1720, date 29.10.2008 "për kriteret e percaktimit të niveli të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.</p>						
ii. Synimi i projektit						
Synojme qe te krijohen kushtet optimale per arritjen e objektivave te percaktuar nga SK Vllaznia.						
iii. Aktivitetet kryesore të projektit						
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimit te kushteve te stervitjes ne pallatin e sportit dhe ne palestra shkollore ne bashkepunim me DAR. • Sigurimi i baze material si: uniforma sportive, topa, kosha, etj. • Trajtim ushqimor per sportistet, • Pagese me honorare te trajnereve. • Sigurimi i regjistrimit të ekipit në Kampionatin Kombëtar. 						
b) Rezultatet që prisni						
<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i kushteve sa me te mira te mundshme per zhvillimin e stervitjes se ekipit te basketbollit te te rinjve me qellim arritjen e objektivave te ekipit. • Shpallja e ekipit kampion për sezonin 2018-2019. 						
c) Aktoret e mundshëm				d) Kontributet e mundshme në projekt		
SK "Vllaznia", shoqata sportive, sportedashesit.				Bashkia Shkodër		
e) Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Trajtime ushqimore	276			276	
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)	194			194	
A.3	Federimi	100			100	
	Shuma	570			570	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime operative	570			570	
	Shuma	570			570	
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime
A.1	Shpenzime operative	570			570	
	Shuma	570			570	
f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon) Janar 2019- Dhjetor 2019		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: SK Vllaznia Bashkia Shkodër				



BASHKIA
SHKODËR

Janar 2020- Dhjetor 2020
Janar 2021- Dhjetor 2021

Institucioni likuidues : Sport Klubi Vllaznia



Nr.18	P08130.03.A3. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra te rritura	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Ekipi i basketbollit SK "Vllaznia" si pjesë e Shoqates Vllaznia që në vitin 1934, merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHB.</p> <p>Ekipi i të rriturve për femra i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.</p> <p>Ky ekip ka arritur në vazhdimësi rezultate të larta në të gjitha aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare. Fitues i kupës së Republikës 2 herë në vitet 1962,1988.</p> <p>Për vitin 2019 synimi është të renditet në kater finalistet e pare, duke siguruar pjesëmarrjen ne fazën Play-off.</p> <p>Baza ligjore per trajtimet ushqimore/trajnerë apo pagesa per federime</p> <p>Urdher nr.217, date 04.07.2018 " per vlerësimin vjetor të trajtimit ushqimor per sportistet e Sport Klub " Vllaznia", ku jane shpërblyer nivelet e vlerësimit sipas kategorive te sportistëve (nivele shume i mire, niveli i mire, niveli mesatar, niveli pranueshem me kuotat ditore leke/dite.</p> <p>Ligjit nr.79/2017 "për sportin",</p> <p>VKM nr.354, DATE 29.8.1994 "per shpërblimin e cilesise te veprimtarive sportive,per sportistet, trajneret e gjyqtaret dhe shpërblime te tjera sportive", i ndryshuar</p> <p>VKM nr 1720, date 29.10.2008 "për kriteret e përcaktimit të niveli të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin e aktiviteve të ekipit te basketbollit për të rritur për femra.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit ose palestra shkollore në bashkëpunim me DAR. • Sigurimi i bazës materiale si: Topa basketbolli, uniforma sportive, etj • Trajtim ushqimor të sportistëve • Pagesë me honorare të trajnerëve. • Sigurimi i regjistrimit të ekipit në Kampionatin Kombëtar 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> • Ekipi basketbollit i te rriturve per femra arrin objektivat e percaktuara SK Vllaznia. • Ekipi të renditet 4 ekipeve më të mira të Kampionatit Kombëtar dhe të jetë pjesë e fazës Play Off. 							
c) Aktoret e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
SK "Vllaznia", shoqata sportive, sportedashesit.		Bashkia Shkodër					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Trajtime ushqimore	1938			1938		
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)	132			132		
A3.	Federimi	130			130		
	Shuma	2200			2200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	2200			2200		
	Shuma	2200			2200		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	2200			2200		
	Shuma	2200			2200		
f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon) Janar 2019- Dhjetor 2019 Janar 2020- Dhjetor 2020 Janar 2021- Dhjetor 2021		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: SK Vllaznia Bashkia Shkodër Institucioni likuidues : Sport Klubi Vllaznia					



Nr.19	P08130.O3.A4. Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja	Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim					
a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:							
i. Situata							
<p>Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra SK "Vllaznia" si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1968 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHB.</p> <p>Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra SK "Vllaznia" përbëhet nga 15 sportiste dhe 1 trajner.</p> <p>Gjatë historisë së tij ky ekip ka zënë gjithnjë vënde të kënaqshme në renditje në aktivitetet e zhvilluara.</p> <p>Kampione kombëtare në vitin 2016 dhe 2017.</p> <p>Për vitin 2019 synon të zërë vendin e parë në kampion kombëtar për të reja.</p> <p><u>Baza ligjore për trajtimet ushqimore/trainere apo pagesa për federime</u></p> <p>Urdher nr.217, date 04.07.2018 " për vlerësimin vjetor të trajtimit ushqimor për sportistet e Sport Klub " Vllaznia", ku janë përcaktuar nivelet e vlerësimit sipas kategorive të sportistëve (niveli shumë i mire, niveli i mire, niveli mesatar, niveli pranueshem me kuotat ditore leke/dite.</p> <p>Ligjit nr.79/2017 "për sportin",</p> <p>VKM nr.354, DATE 29.8.1994 "për shpërblimin e cilesise të veprimtarive sportive,për sportistet, trajneret e gjyqtaret dhe shpërblime të tjera sportive", i ndryshuar</p> <p>VKM nr 1720, date 29.10.2008 "për kriteret e përcaktimit të niveli të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimën e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.</p>							
ii. Synimi i projektit							
Sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin e aktiviteteve sportive të ekipit të basketbollit të të rinjve për femra SK "Vllaznia.							
iii. Aktivitetet kryesore të projektit							
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i kushteve të stervitjes në pallatin e sportit dhe në palestrat e ndryshme shkollore në bashkëpunim me DAR. • Sigurimi i trajtimit ushqimor të sportistëve • Pagesa me honorare të trajnerëve. 							
b) Rezultatet që prisni							
<ul style="list-style-type: none"> • Ekipi i basketbollit të të rinjve për femra • Sigurimi i regjistrimit të ekipit në Kampionatin Kombëtar. 							
c) Aktoret e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt					
SK "Vllaznia", shoqata sportive, sportedashesit.		Bashkia Shkodër					
e) Shpenzimet e llogaritura							
Shpenzimet për çdo aktivitet 2019		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Trajtime ushqimore	283			283		
A.2	Pagesa honorare (trajner)	97			97		
A.3	Federimi	100			100		
	Shuma	480			480		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2020		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	480			480		
	Shuma	480			480		
Shpenzimet për çdo aktivitet 2021		Totali (mije lekë)	Nga kjo:				
			Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale
A.1	Shpenzime operative	480			480		
	Shuma	480			480		



f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)

Janar 2019- Dhjetor 2019
Janar 2020- Dhjetor 2020
Janar 2021- Dhjetor 2021

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

SK Vllaznia
Bashkia Shkodër
Institucioni likuidues : Sport Klubi Vllaznia



Nr.20	<p>P08130.O3.A5.</p> <p>Mbështetje e ekipit të volejbollit meshkuj të rritur</p>	<p>Funksioni 8:Argëtim, kultura dhe feja</p> <p>N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive</p> <p>Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim</p>																																										
<p>a)Përshkrimi i shkurtër i projektit:</p>																																												
<p>i. Situata</p> <p>Ekipi i volejbollit SK "Vllaznia", si pjesë e Shoqates Vllaznia që në vitin 1924 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHV. Ekipi i të rritur i Vllaznisë përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë. Fitues i kupës së Republikës 3 herë në vitet 1969, 1970, 1973. Kampion Kombëtar për here të pare ne vitin 2017. Në sezonin e ri sportiv, ky ekip synon të jetë pjesë e katër ekipeve më të mira të kampionatit dhe te arrije fazen play-off. Baza ligjore per trajtimet ushqimore/trajnerë apo pagesa per federime Urdher nr.217, date 04.07.2018 " per vlerësimin vjetor të trajtimit ushqimor per sportistet e Sport Klub " Vllaznia", ku jane percaktuar nivelet e vleresimit sipas kategorive te sportisteve (niveli shume i mire, niveli i mire, niveli mesatar, niveli pranueshem me kuotat ditore leke/dite. Ligjit nr.79/2017 "për sportin", VKM nr.354, DATE 29.8.1994 "per shperblimin e cilesise te veprimtarive sportive,per sportistet, trajneret e gjyqtaret dhe shperblime te tjera sportive", i ndryshuar VKM nr 1720, date 29.10.2008 "për kriteret e përcaktimit të niveli të lartë sportiv, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimim e trajtimit për përgatitjen sportive", të ndryshuar.</p>																																												
<p>ii. Synimi i projektit</p> <p>Mbarëvajtja e ekipit të volejbollit më qellim rritjen e cilësise sportive dhe arrijten e objektivave të përcaktuara.</p>																																												
<p>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurim i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit ose palestra shkollore në bashkëpunim me DAR. • Sigurimi i bazës materiale si: topa, complete sportive, uniforma, rrjeta volejboli, etj. • Trajtim ushqimor të sportistëve • Pagese me honorare të trajnerëve, • Pagesa për gjyqtarët . 																																												
<p>b) Rezultatet që prisni</p> <p>Kushtet e mira për stërvitjen e ekipit, ndikojnë në arrijten e objektivave të ekipit të volejbollit të të rriturve për meshkuj.</p>																																												
<p>c) Aktoret e mundshëm</p> <p>SK "Vllaznia", shoqata sportive, sportedashesit.</p>		<p>d) Kontributet e mundshme në projekt</p> <p>Bashkia Shkodër</p>																																										
<p>e) Shpenzimet e llogaritura</p>																																												
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</p>		<p>Totali (mije lekë)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="6">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Pag a</th> <th>Sigurim e</th> <th>Operativ e</th> <th>Transferim e</th> <th colspan="2">Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Trajtimeushqimore</td> <td>2890</td> <td></td> <td>2890</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.2</td> <td>Pagesa honorare (trajnerë)</td> <td>264</td> <td></td> <td>264</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.3</td> <td>Pagesagjyqtarësh</td> <td>200</td> <td></td> <td>200</td> <td></td> </tr> <tr> <td>A.4</td> <td>Federime</td> <td>146</td> <td></td> <td>146</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma</td> <td>3500</td> <td></td> <td>3500</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nga kjo:						Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale		A.1	Trajtimeushqimore	2890		2890		A.2	Pagesa honorare (trajnerë)	264		264		A.3	Pagesagjyqtarësh	200		200		A.4	Federime	146		146			Shuma	3500		3500	
Nga kjo:																																												
Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale																																								
A.1	Trajtimeushqimore	2890		2890																																								
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)	264		264																																								
A.3	Pagesagjyqtarësh	200		200																																								
A.4	Federime	146		146																																								
	Shuma	3500		3500																																								
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2020</p>		<p>Totali (mije lekë)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="6">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Pag a</th> <th>Sigurim e</th> <th>Operativ e</th> <th>Transferim e</th> <th colspan="2">Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Shpenzime operative</td> <td>3500</td> <td></td> <td>3500</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma</td> <td>3500</td> <td></td> <td>3500</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nga kjo:						Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale		A.1	Shpenzime operative	3500		3500			Shuma	3500		3500																			
Nga kjo:																																												
Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale																																								
A.1	Shpenzime operative	3500		3500																																								
	Shuma	3500		3500																																								
<p>Shpenzimet për çdo aktivitet 2021</p>		<p>Totali (mije lekë)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="6">Nga kjo:</th> </tr> <tr> <th>Pag a</th> <th>Sigurim e</th> <th>Operativ e</th> <th>Transferim e</th> <th colspan="2">Kapitale</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A.1</td> <td>Shpenzime operative</td> <td>3500</td> <td></td> <td>3500</td> <td></td> </tr> <tr> <td></td> <td>Shuma</td> <td>3500</td> <td></td> <td>3500</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nga kjo:						Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale		A.1	Shpenzime operative	3500		3500			Shuma	3500		3500																			
Nga kjo:																																												
Pag a	Sigurim e	Operativ e	Transferim e	Kapitale																																								
A.1	Shpenzime operative	3500		3500																																								
	Shuma	3500		3500																																								



f) Periudha e zbatimit (kurfillon, kurpërfundon)

Janar 2019- Dhjetor 2019
Janar 2020- Dhjetor 2020
Janar 2021- Dhjetor 2021

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

SK Vllaznia
Bashkia Shkodër
Institucioni likuidues : Sport Klubi Vllaznia





BASHKIA
SHKODËR
P08130.O3.A6.

Nr.21

Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura

Funksioni 8: Argëtim, kultura dhe feja

N/Funksioni 081: Shërbime rekreative dhe sportive

Llojet e programit 08130: Sport dhe argëtim

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:

i. Situata

Ekipi i volejbollit SK "Vllaznia" si pjesë e Shoqatës Vllaznia që në vitin 1925 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHV.

Ekipi i volejbollit te te rriturve per femra perbehet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

Ky ekip është shpallur kampion kombëtar 3 herë në vitet 1947, 1957, 1960.

Fitues i Kupës së Republikës 3 herë, në vitet 1962, 1963, 1964.

Për vitin 2019 objektivi i këtij ekipi është të hyjë mes katër ekipeve me të mira të kampionatit kombëtar.

Baza ligjore për trajtimet ushqimore/trainere apo pagesa për federime

